VENDIM
Nr. 196, datë 13.4.2007

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E DOKUMENTIT TË IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE ELEKTRONIKE TË SHTETASVE SHQIPTARË" DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME

(Ndryshuar me VKM nr. 525, datë 8.8.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë", të pikave 4, shkronja "a", e 5 të nenit 19 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe të pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë", sipas aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. *Shfuqizuar.*
3. *Shfuqizuar.*
4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha